

VENDIM
Nr. 338, datë 4.5.2016

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA ALBAFILM SHA TE
MINISTRIA E KULTURËS, TË OBJEKTIT “ISH-LABORATORI I FILMIT”, NË ZONËN
KADASTRALE 8130, DHE PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2016,
MIRATUAR PËR MINISTRINË E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10, 13, 15 e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Kulturës dhe ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Albafilm sh.a. te Ministria e Kulturës, të objektit “Ish-laboratori i filmit”, në zonën kadastrale 8130, me sipërfaqe të përgjithshme 4 918 (katër mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë) m², nga të cilat 1 420 (një mijë e katërqind e njëzet) m² sipërfaqe objekti dhe 3 498 (tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) m² sipërfaqe funksionale, sipas genplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për t’u përdorur për nevoja të Ministrisë së Kulturës.

2. Vendimi nr. 1445, datë 29.10.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënien me qira, pa konkurrim, “Top Channel” sh.a., të objektit “Ish-laboratori i filmit”, në pronësi të Albafilm sh.a., Tiranë”, revokohet.

3. Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2016, i shtohet fondi prej 38 725 768 (tridhjetë e tetë milionë e shtatëqind e njëzet e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekësh, për rregullimin e pasojave nga zgjidhja e kontratës së qirasë me subjektin “Top Channel” sh.a.


Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.



- ☐ 1. Sip. objekti 1420 m²
- ☐ 2. Sip. funksionale 3498 m²
- ☐ 3. Sip. totale = 4918 m²

Burton KACELI

Kufizimet

Veri — Rruge

Jug - *Ish of. metal prerese*

Lindje — Rruge

Perendim - Atelieri i madh i filmit

OBJEKTI	Rilevim Topografik	Licenses	Firma
AUTOR	Top. Edison SINANAJ	ES-2	Sh.p.k
POROSITES:			
RILEVIMIN E KREU "ES-2" shpk		Lic. N.5020	
Tel. 04/2225072 Cel. 0692078883			

